




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.554/2023
Datë: 27 dhjetor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 7 dhe 34 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në vazhdimin e takimit 318-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet projekt plani i punësimit 5 vjeçar, që përfshin periudhën 2025 – 2029 për Sekretariat, Njësi dhe Gjykata.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2023.

A r s y e t i m

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore ka përgatitur projekt planin e punësimit 5 vjeçar, që përfshin periudhën 2025 – 2029, i cili bazohet në pozitat të cilat sipas fuqisë ligjore arrijnë moshën e pensionin në Sekretariat, Njësi dhe Gjykata.

Këshilli, ka shqyrtuar dhe diskutuar lidhur me propozimin e paraqitur nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore rreth analizës sa i përket gjendjes aktuale në sistemin gjyqësor, nevojës për shtimin e numrit të punonjësve profesional dhe zvogëlimin e numrit të punonjësve teknik-mbështetës në gjykata. Po ashtu, Këshilli vlerësoj të dhënat e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që konfirmojnë se zbatimi i këtij vendimi ndihmon në përmirësimin e performancës në përgjithësi dhe nuk paraqet vështirësi buxhetore.

Pas shqyrtimit të propozimit, Këshilli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.